

# Nënkryetari i Komunës për komunitete

2022  
janar-dhjetor

Emërimi i Nënkryetarit për Komunitete (NKK) është obligativ në komunat ku komunitetet jo-shumicë përbëjnë së paku dhjetë për qind të banorëve të komunës. Me vendim të Kuvendit të Komunës (KK), ai/ajo mund të emërohet edhe në komunat ku komunitetet jo-shumicë nuk e plotësojnë pragun prej dhjetë për qind. Kandidati për NKK propozohet nga Kryetari i Komunës dhe miratohet nga KK-ja. NKK-ja është i mandatuar të ofrojë këshilla dhe udhëzime për Kryetarin e Komunës për çështjet që kanë të bëjnë me komunitetet dhe duhet të përfaqësojë të gjitha komunitetet që banojnë në komunë.

## Dokumentet kryesore

- Ligji për Vetëqeverisjen Lokale (Nr. 03/L-040, 2008);
- Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 02/2020 për procedurën e emërimit të nënkryetarëve të komunave;
- Termat e referencës për NKK-të.

\* Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 01/2014 është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 02/2020 për procedurën e emërimit të nënkryetarëve të komunave më 21 shtator 2020.

## Themelimi

NKK-të janë caktuar në 16 komuna.

### Pozita të krijuara për NKK \*


Dragash	Lipjan
Ferizaj	Mamushë
<b>Fushë Kosovë</b>	<b>Novobërdë</b>
Gjilan	Obiliq
<b>Graçanicë</b>	Pejë
Istog	Ranillug
Kamenicë	<b>Shtërpcë</b>
<b>Kllokot</b>	Zveçan <sup>1</sup>

<sup>1</sup> Mungesa e të dhënave zyrtare të regjistrimit për këto komuna krijon paqartësi në lidhje me themelimin e pozitës. Prandaj, për qëllim të kësaj analize janë përdorur përlogaritjet e banorëve në profilet komunale të Misionit të OSBE-së në Kosovë 2018. (Gjendet tek <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/municipal-profiles>)

\* **Me bold** janë përshkruar pozitat e NKK-ve që janë obligative sipas të dhënave zyrtare të regjistrimit të popullsisë.


NB. Në Prizren dhe Mitrovicë Veriore, NKK-ja është pozitë e detyrueshme, por pozita ka qenë e lirë gjatë periudhës raportuese.

## Qasja në burime financiare \*




## Përfaqësimi i komuniteteve dhe gjinive

### Përfaqësimi i komuniteteve



- Shqiptar i Kosovës
- Egjiptian i Kosovës
- Turk i Kosovës
- Serb i Kosovës
- Ashkali i Kosovës
- Boshnjak i Kosovës
- Goran i Kosovës

### Përfaqësimi gjinor



\* Një grua (serbe e Kosovës) është emëruar si NKK vetëm në komunën e Kamenicës.

# Performanca në vitin 2022


## Treguesit e përzgjedhur të performancës

Numri i NKK-ve që kanë ndërmarrë aktivitete kyçe dhe detyra thelbësore të parapara me kornizën ligjore dhe të politikave. Informacioni bazohet në monitorimin e rregullt nga ekipet e terrenit të Misionit të OSBE-së në Kosovë dhe shqyrtimet periodike specifike, si dhe në raportet e prodhuara nga komunat, që mbulojnë vitet 2020-2022.


Shënim 1: të dhënat e vitit 2021 mbulojnë periudhën para zgjedhjeve komunale, përkatësisht nga janari deri në tetor 2021.  
Shënim 2: Në vlerësimin e performancës kanë marrë pjesë 14 nga 16 NKK të emëruar. Informatat për NKK-të në Fushë Kosovë dhe Kamenicë nuk janë të disponueshme, e rrjedhimisht nuk përfshihen në këtë vlerësim.

### 1 – Këshilla, udhëzime dhe mbikëqyrje

Ofrimi i këshillave dhe angazhimi në aktivitete dhe udhëzime për Kryetarin e komunës për çështjet e komuniteteve




Konsultimi me kryetarin e komunës për nevojat dhe interesat e komuniteteve në përgatitjen e buxhetit



### 2 – Buxheti


Të siguruarit e ndarjes së fondeve të mjaftueshme për mekanizmat komunalë në interes të drejtave të komuniteteve



■ 2022 ■ 2021 ■ 2020


### 3 – Promovimi i dialogut midis komuniteteve

Angazhimi në aktivitete në promovim të dialogut ndërkomunitar




### 4 – Bashkëpunimi

Veprimi si person kontaktues për implementimin e rekomandimeve nga KK




Promovimi i përfshirjes direkte të komuniteteve në aktivitetet e KK-së



### 5 – Raportimi

Raportimi tek Kryetari çdo gjashtë muaj



## Performanca e përgjithshme

Rezultatet e performancës së NKK-ve bazohen në rezultatet e përmbledhura të treguesve të performancës, të cilët pasqyrojnë aktivitetet kryesore dhe detyrat thelbësore të parapara me kornizën ligjore dhe politikat përkatëse. Performanca vlerësohet "e lartë" kur rezultati i mbledhur është mbi 66 për qind, "mesatare" kur luhet midis 66 për qind dhe 33 për qind, si dhe "e ulët" kur është nën 33 për qind.

Misioni i OSBE-së në Kosovë mbështet pjesëmarrjen e rritur të komuniteteve në proceset dhe institucionet e vendimmarrjes dhe qeverisjes publike. Për të ndihmuar në këtë përpjekje, Misioni i OSBE-së në Kosovë monitoron rregullisht performancën e mekanizmave mbrojtës të komuniteteve komunale. Këto fletë informacioni synojnë t'u ofrojnë institucioneve përkatëse tregues që mund të ndihmojnë në identifikimin e mangësive dhe përmirësimin e pajtueshmërisë.

	Këshillat, udhëzimet dhe mbikëqyrja	Buxheti	Promovimi i dialogut ndërmjet komuniteteve	Bashkëpunimi	Raportimi	PERFORMANCA E GJITHMBARSHME
Dragash	E lartë	E ulët	Mesatare	Mesatare	E lartë	64%
Ferizaj	E lartë	E ulët	Mesatare	Mesatare	E lartë	71%
Gjilan	E lartë	E ulët	E ulët	E ulët	E lartë	48%
Graçanicë	E lartë	E ulët	Mesatare	E ulët	E ulët	38%
Istog	E lartë	E ulët	Mesatare	E ulët	E lartë	49%
Kllokot	E lartë	E ulët	Mesatare	Mesatare	E lartë	66%
Lipjan	E lartë	E lartë	E lartë	E lartë	E lartë	99%
Mamushë	E ulët	E ulët	E ulët	E ulët	E ulët	23%
Novobërdë	E lartë	E lartë	E ulët	Mesatare	E ulët	55%
Obiliq	E lartë	E lartë	E lartë	E lartë	E ulët	73%
Pejë	E lartë	E lartë	E lartë	E lartë	E lartë	95%
Ranillug	E lartë	E lartë	E lartë	E lartë	E lartë	88%
Shtërpcë	E ulët	E ulët	E ulët	E ulët	E ulët	23%
Zveçan	E lartë	E ulët	E ulët	E ulët	E ulët	23%
<b>PERFORMANCË MESATARE 2022</b>	<b>81%</b>	<b>40%</b>	<b>50%</b>	<b>48%</b>	<b>57%</b>	<b>55%</b>
<b>PERFORMANCË MESATARE 2021</b>	<b>88%</b>	<b>59%</b>	<b>55%</b>	<b>59%</b>	<b>68%</b>	<b>66%</b>